



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-109
Prishtinë, më 29 qershor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë K R Y E S I S Ë S Ë K U V E N D I T, T Ë M B A J T U R M Ë 2 9 Q E R S H O R 2 0 1 0

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Xhezair Murati dhe Petar Miletqi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi.

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE: Floriana Shala dhe
Nga NDI, Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 qershor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që në mbledhjen tjetër të radhës (data do të caktohet më vonë) të shqyrtohen këto pika:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrje Financiare lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009, dhe
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Programin Kombëtar të Shkencës.

Kryesia vendosi që edhe pika të tjera, që përgatiten ndërkohë, mund të radhiten në rend dite për mbledhjen plenare të ardhshme.

Kryesia, gjithashtu, diskutoi për pikën e parë të rendit të ditës - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Diskutimi u përqendrua për mënyrën e paraqitjes dhe rendin e diskutuesve, që dëshirojnë të deklarojnë ndonjë çështje, që nuk është e përfshirë në rend dite të mbledhjes plenare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Strategjisë së sigurisë së Republikës së Kosovës

Kryesia lidhur me Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri që ta shqyrtojë Propozim – Strategjinë e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.2 Shqyrtimi i Strategjisë së Privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës

Kryesia lidhur me Strategjinë e privatizimit të Postë-Telekomunikacionit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Propozim – Strategjinë e privatizimit të Postë-Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.3 Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2009

Kryesia lidhur me Raportin vjetor të Bankës Qendrore, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.4 Shqyrtimi i mocionit të Grupit Parlamentar të LDD-së për debat parlamentar lidhur me privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës

Kryesia konstatoi që mocioni i Grupit Parlamentar të LDD-së për të debatuar lidhur me privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës, të radhitet në rend dite të mbledhjes plenare, sipas nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit.

3.5 Kërkesa e deputetit Emrush Xhemajli, mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-2 për statusin e familjarëve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të familjeve të viktimave civile të luftës

Kryesia lidhur me kërkesën e deputetit Emrush Xhemajli, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria që të përshpejtojë procedimin e Projektligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të familjeve të viktimave civile të luftës, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

3.6 Njoftimi i Komisionit për Arsim Shkencë, Teknologji, Kulturë Rini e Sport lidhur me vizitën e realizuar në Republikën e Turqisë

Kryesia u informua për vizitën e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë Rini e Sport, të realizuar në Parlamentin e Turqisë, prej 9 deri më 13 qershor 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale